



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 45

Prishtinë, më 07.12.2015, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; – Taulant Kryeziu Kabinet/MD; Baki Gimolli-MD; Dibran Istrefi- Klan Kosova; Florina Merovci, ZPRK; Petrit Hysaj, OSBE; –Lekë Batalli, GLPS; -Mergime Kajtazi-, KDI; Etrur Maloku-Ambasada Amerikane; Bujar Tresi-RTV 21 dhe Albert Krasniqi, KDI.

Nga Staf i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.11.2015;
3. Shqyrtimi i propozim -amendamentit të Qeverisë së Republikës së Kosovës që ka të bëjë me nenin 108 të Kushtetutës;
4. Diskutim lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga Kuvendi;
5. Shqyrtimi i projektligjit nr.05/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.11.2015.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 19.11.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozim-amendamentit të Qeverisë së Republikës së Kosovës që ka të bëjë me nenin 108 të Kushtetutës

Kryesuesja-Në fjalën e saj tha që tashmë i kemi materialet me ri-procedim të amendamentit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, të vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me Aktgjykim nr. Ref. AGJ303/12 dt. 31 tetor 2012. Kryesuesja theksoj se Qeveria e Kosovës e ka dërguar edhe një herë që të ri-procedohet propozim-amendamenti për plotësim ndryshimin në Kushtetutën e Kosovës, më konkretisht neni 108. Kryesuesja kërkoi që komisioni të japë mendimin e vet në lidhje me kërkesën e Qeverisë për ri-procedim, dhe hap debat për këtë çështje.

Armend Zemaj – Nënvizoi se si Komision, është hera e dytë që po merremi me këtë Projektligj pasi që i njëjti, sipas tij, më herët është tërhequr nga Qeveria dhe ri-proceduar. Në vazhdim Zemaj tha se është marrë një konfirmim i amendamenteve të Kushtetutës, më 22 qershor 2012, dhe si grup punues ka shqyrtuar projektligjin, dhe sipas tij, meqë kemi të bëjmë me organizimin e gjyqësorit, më konkretisht ndarjen e pushteteve, kërkoi që kjo çështje të trajtohet në mënyrë të veçantë. Zemaj theksoi se komisioni ka pasur disponim që Kuvendi të jetë më i liruar të mos ngarkohet me përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, por mbi të gjitha ai kërkoi të krijohet një raport demokratik institucional, i cili do t'i shërbej vendit në përgjithësi. Në fund deputeti Zemaj propozoi të ftohet sponsorizuesi i cili duhet të sqarojë se si i ndihmon sistemit në përgjithësi ky ndryshim kushtetues. Kjo, kërkoi Zemaj, të bëhet pasi të jetë këshilli funksional, meqë pritet që të bëhet zgjedhja e anëtarëve nga komuniteti serb dhe Oda e Avokatëve, që sipas tij, duke parë gjendjen aktuale që e kemi, kërkoi që kjo çështje të lihet për sesionin pranveror.

Kryesuesja - Në vazhdim lexoi shkresën nga Ministria e Drejtësisë, e aprovuar në Qeverinë e Kosovës, ku propozohet si amendament për ndryshime në Kushtetutë, e ku thuhet: “Ministria e Drejtësisë ka propozuar amendamentin e Kushtetutës së Kosovës sa i përket zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, ku propozohet që numri i anëtarëve të Këshillit të rritet nga 5 në 7 të cilët zgjidhen nga anëtarët e gjyqësorit. Amendamentimi i Kushtetutës në këtë çështje është rekomanduar nga Raporti i Progresit 2014, në pikën 2.1, ku sugjerohet që Kushtetuta të modifikohet në mënyrë që të sigurojë se shumica e anëtarëve të Këshillit të zgjidhen nga vetë kolegët e tyre në përputhje me rekomandimet e komisionit të Venecias.”. Në vazhdim kryesuesja thekson që ky amendament, si i tillë duhet të procedohet për faktin që kjo u jep pavarësi me të madhe organeve të drejtësisë dhe ato do të lirohen nga të përzgjedhurit e Kuvendit në Këshillin Gjyqësor. Duke marrë parasysh rrethanat e papërshtatshme që të bëjmë modifikim të Kushtetutës ky propozim ndryshim të mbetet për sesionin pranveror.

Agim Aliu- Tha edhe pse jemi të ballafaquar me bllokada, çështja që jemi marrë më së shumti si komision ka qenë çështja e Këshillit Gjyqësor. Sipas tij, gjyqësori shumë shpesh ka qenë atak, si nga mekanizmat kombëtarë dhe ata ndërkombëtarë, e nuk po funksionon mirë dhe për këtë arsye, komisioni ka pasur dilemat se si ta bëjë më të mirën për të pasur një gjyqësor sa më efikas dhe të pavarur. Më tej Aliu shtoi se duke parë këtë, komisioni ka reflektuar dhe janë marrë vendime që kanë të bëjnë me Këshillin Gjyqësor, dhe sipas tij, pas amendamentimit të nenit 25 do të hapen mundësitë për të diskutuar edhe njëherë për Ligjin për Këshillin Gjyqësor, që ky institucion të jetë në funksion të asaj që është krijuar, pra vendosja në binar e drejtësisë dhe bërja e saj për atë çfarë duhet të jetë. Aliu më pas shprehu edhe dilemat e tij se sa do të jetë e mundur me një Ligj të tillë dhe me një amendamentim të bëhet zgjidhja më këtë zhvendosje të dy gjyqtarëve, duke marrë një të drejtë nga Kuvendit dhe kjo përgjegjësi t'i bartet Këshillit Gjyqësor, duke theksuar se nuk e di nëse kjo do t'i shërbejë qëllimit që komisioni ka vendosur. Po sidoqoftë, Aliu u pajtua që diskutohet edhe me sponsorizuesin dhe të merren hapa të mëtutjeshëm në sesionin pranveror. Në fund Aliu tha se hapat që po shkojnë në ndërtimin e strukturës së Këshillit Gjyqësor, po bëhen në drejtim të jo atakimit apo politizimit, kjo është gjë e mirë dhe duhet përshëndetur.

Armend Zemaj- Kërkoi të sqarohet në pjesën e fundit që tha zoti Aliu, që të krijohet siguria ligjore për gjyqësorin, se do të jetë pavarësia e plotë nga institucionet e tjera. Ai më tej shtoi, se sot edhe ashtu komisioni është i ngarkuar të bëjmë vlerësimin e përputhshmërisë së tekstit për propozim amendamentin e propozuar në Kuvend në vitin 2012, me tekstin që sot ka ardhur nga Qeveria. Zemaj tha se qëndron prapa asaj se Kuvendi duhet të bindet, pasi është ndryshim kushtetues që do të bëhet, pasi sipas tij, po të kishte ndodhur në vitin 2012, Këshilli do të kishte strukturën tjetër dhe Kuvendi nuk do të ishte i ngarkuar me këto lloj diskutime. Sidoqoftë, ai kërkoi që të shikohet logjika e prapa veprimit të ndryshimit kushtetues sa i përket mandateve funksionale që janë dhe kohëzgjatjes së viteve. Ndërsa sa i përket tekstit, Zemaj tha se është në rregull sepse është i njëjti me vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, dhe se për hapat e mëtejme duhet aprovim i Kuvendit në lidhje me këtë kërkesë.

Kryesuesja- Pranoi ekzistimin e përputhshmërisë së teksteve, por kërkoi më tepër kohë, për ta evituar situatën si në vitin 2012 kur nuk ka kaluar në Kuvend. “Sa më shumë të ndikojmë që të kemi një gjyqësor të pavarur dhe efikas dhe të pavarur nga politika duke përdorur të gjitha mekanizmat, qoftë plotësim-ndryshimin e kushtetutës ose plotësim-ndryshimin e ligjeve, ne duhet të kryejmë punën tonë në harmoni me atë për të cilën jemi zgjedhur në kuvend”, tha kryesuesja duke shtuar se sa me pak njerëz të dërguar përmes procedurës nga ana e kuvendit, të cilitdo këshill, përgjegjësia do të jetë me e adresuar në atë këshill që i zgjedh njerëzit e vet sipas kompetencave që ia jep ligji.

Agim Aliu- Në fjalën e tij të serishme kërkoi të bëhet një ligj cili pamundëson çështjen e veprimit të disa grupeve të caktuara përbrenda sistemit të drejtësisë. Pra gjithçka të përcaktohet me ligj, e jo të lihet në dorën e tyre, sepse mund të ndodhë pastaj që grupe të caktuara të interesit të imponojnë që të jenë pjese e këtij këshilli. Në fund tha ai se kjo çështje lihet të diskutohet me vonë.

Kryesuesja - Në fjalën e saj tha se pajtohet plotësisht me z. Aliu, por nënvizoi se është organi kompetent ku adresohet përgjegjësia. Sipas saj, pavarësisht gupeve të vogla brenda sistemit të cilat mund të pamundësojnë realizimin e asaj që kemi si qëllim, ajo tha se po zotohemi çdo ditë për një depolitizim të sistemit të drejtësisë, duke shtuar se është në dorën tonë që me ligj t'i mbyllem ato hapësira ku mund të manipulohet.

Në fund, meqë nuk kishte tjetër gjë për t'u shtuar, kryesuesja propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të përfundojë, por ndërhyu **z. Nezir Çoçaj**-i cili tha se kjo çështje ka kaluar në kabinet të Qeverisë dhe gjithashtu është vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese. Andaj, sipas tij, nuk ka nevojë të merremi më shumë me këtë çështje. Ai propozoi që komisioni ta kalojë këtë pikë e pastaj në sesionin pranveror të dalë në Kuvend, dhe kuvendi ka mandat që në seancë ta votojë apo jo.

Në vazhdim **kryesuesja** tha: Meqë nuk është përbërja e plotë e komisionit dhe pasi që kemi të bëjmë me ndryshim kushtetues, sipas saj, do ishte mirë të ekzistonte konsensus me të gjitha partitë politike, duke shprehur dilemat e saj që kjo çështje të vihet në komision për miratim. Por sido që të jetë, ajo pranoi se përputhshmëria e tekstit ekziston, mendimin i gjykatës është, dhe tha se nëse komisioni pajtohet, kjo mund të shkojë në Kuvend.

Agim Ademaj u shpreh se si komision disponimi ekziston që kjo pikë e rendit të ditës të kalojë, por sipas tij komisioni duhet të ketë përbërje të plotë, duke përkujtuar se në vitin 2012 kjo çështje nuk ka kaluar për mungesë konsensusi në parlament. Prandaj që mos të krijohet një situatë e njëjtë sërish, Ademaj propozoi që të lihet në sesionin pranveror, atëherë kur edhe opozita të jetë e pranishme.

Armend Zemaj – Potencoi sërish se tekstet janë në përputhshmëri të plotë, vetëm duhet që komisioni të dalë me një përfundim se si të procedohet. Por ai gjithashtu nënvizoi se duhet një komunikim më i gjerë se sa një takim i komisionit, qoftë me ata që hartojnë politikën se çfarë sistemi gjyqësor kemi, deputetëve si ligjvënës dhe shtyllës së pavarur të gjyqësorit.

Nezir Çoçaj- Tha se ne, si komision, e kemi diskutuar edhe çështjen e Këshillit Prokurorial edhe Këshillit Gjyqësor, ndërsa sa i përket se çka ka bërë sponosorizuesi ne nuk mund të ndërhyjmë, më tej shtoi, se kjo përzgjedhje është në favor të Këshillit Gjyqësor, sepse po rritet numri i anëtarëve nga 5 në 7 dhe nuk besoj se 2 anëtarë të përzgjedhur nga Kuvendi mund të kenë ndikim në vendimet e tyre. Mendoj se nuk duhet të shtyhet, po le të vendosin Kryesia dhe Kuvendi si organe me të larta se komisioni.

Pas diskutimeve, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

- I. Të miratohet amendamenti kushtetues që ka të bëjë me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafët 1 dhe 2, i riproceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës;
- II. Teksti amendamentit të riproceduar më 30.11.2015, është i njëjtë me tekstin e propozim-amendamentit, të datës 31 tetor 2012, i vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me aktgjykimin nr. AGJ303/12.

4. Diskutim lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga Kuvendi

Kryesuesja – Njoftoi se sipas ligjit të ri janë të obliguar të hapin konkurs për anëtarë të Këshillit Gjyqësor, i cili ka të bëjë me përfaqësues të Odës së Avokatëve dhe përfaqësuesit e komunitetit serb. Sipas raportit, është vetëm një kandidat nga Oda e Avokatëve, që në fakt do duhej të ishin dy, në mënyrë që emrat të mund të dërgohen në Kuvend. Si rezultat i kësaj, konkursi për përfaqësuesin e Odës së Avokatëve duhet të rishpallet. Ndërsa sa i përket kandidatëve të komunitetit serbë, kryesuesja njoftoi se gjithçka është në rregull, pasi që janë 3 kandidatë, për të cilët do të mbahet intervista, nga ku 2 prej tyre i dërgohen Kuvendit për t'u zgjedhur si anëtarë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Kryesuesja gjithashtu nënvizoi, duke u thirr në dispozitat e ligjit, se në momentin që kandidatët zgjidhen anëtarë të Këshillit, atëherë duhet të pushojnë veprimtarinë e tyre si avokat, duke theksuar se 2 nga kandidatët serbë janë avokat dhe se nga ta duhet kërkuar që në momentin e zgjedhjes të pushojnë punën e tyre si avokat aq kohë sa janë anëtarë të Këshillit Gjyqësor. Kryesuesja më tej tha se si konkludim i këtij komisioni për çështjen e konkursit është: të rishpallet sërish konkursi për përfaqësuesin e Odës së Avokatëve. Në fund unanimisht vendoset që intervista të mbahet ditën e premte, më 11.12.2015, në ora 13.

Armend Zemaj- Në fjalën e tij thotë se me ndryshimin e ligjit sigurisht do të ketë prapë pengesa, sepse është pak problem pezullimi i punës si avokat. Ai tha se kur ta shqyrtojmë çështjen e Këshillit Gjyqësor duhet të tregojmë që janë standardet më të mira ndërkombëtare dhe mos të ketë çdo ditë nevojë të bëhen ndërhyrje. Ai më tej shtoi se me këtë ligj nuk plotësohen kushtet sepse na duhet konkurrencë që të ecim më tutje. Në fund vendoset që të gjithë anëtarët e komisionit të jenë prezent gjatë intervistimit të anëtarëve.

Pas diskutimeve, kryesuesja konstatoi se Komisioni, vendosi që intervista të mbahet ditën e premte, më 11.12.2015, në ora 13.

4 Shqyrtimi i projektligjit nr. 05/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-224 për këshillin prokurorial të Kosovës

Nga kryesuesja e mori fjalën z. Zemaj, si udhëheqës i grupit punues, që të raportojë në lidhje me këtë çështje.

Armend Zemaj- Tha se si grup punues kemi mbajtur dy takime për trajtimin e plotësimit ndryshimit të ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ku kontribuan edhe partnerët që e mbështesin Kuvendin, si Komisioni Evropian, përfaqësues të ambasadës, anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Zyra e Prokurorit Disiplinor, kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe anëtarët e komisionit, takime në të cilat është debatuar gjatë. Zemaj tha se sa i përket neneve 2 dhe 4 ishim dakord që është konsumuar, në afatin kohor si dispozitë kalimtare, edhe pse më shumë ishte të precizohet hyrja në fuqi e dispozitës kalimtare, mandatet e anëtarëve të Këshillit që ka të bëjë nga 1 janari i vitit 2016.

Deputeti Zemaj më tej tha se komisioni, grupi punës dhe të gjithë anëtarët e tjerë dolën me një konkludim që nuk ka dilema rreth kohës së mandateve. Te neni 1 që ka të bëjë me ndërhyrje të Ligjit bazik që është kërkuar të riformulohet për mënyrën e funksionimit të anëtarëve. Propozimi, sipas tij, ishte që të lejohet mandati shtesë dhe se në Ligji është vendos që mandatet

të mos jenë të njëpasnjëshme. Deputeti Zemaj potencoi, se komisioni i Venecias ka dhënë mendim, ku është thënë që nuk është mirë që institucionet e drejtësisë të kenë mandate të njëpasnjëshme, pasi konsiderohet që një mandat pesëvjeçar është i mjaftueshëm që të kryhet zotimi, dhe gjithashtu të mos ketë familjarizim të shtuar për 10 vjet. Ai tha se rekomandimet ishin që të mos miratohet ky amendament, meqenëse edhe dy nenet e tjera e kanë humbur rëndësinë. Zemaj tha se ne kemi dhënë rekomandim që ky projektligj të hiqet nga sponsorizuesi dhe mos të miratohet në lexim të dytë. Deputeti Zemaj shton se kanë pasur edhe mendimet e partnerëve që mbështesin Kuvendin e Kosovës, të cilët kishin edhe vërejtjet e tyre që nuk janë konsultuar për këtë plotësim-ndryshim, dhe se çka është menduar të arrihet me këtë, edhe pse edhe ne kemi pasur dilemat tona që të hyjmë në thellësi dhe ta analizojmë mirë se çka e pengon një mandat pesëvjeçar apo një mandat i njëpasnjëshëm për një individ të caktuar.

Në fund Zemaj tha se, si përfundim grupi punues rekomandon ta përkrahim rekomandimin e dhënë, duke thënë se arsyetimin do ta paraqesë edhe në seancë plenare. Më tej ai shton se ashtu si është në ligj të mbetet sepse është më mirë për vetë Këshillin Gjyqësor, por edhe për Këshillin Prokurorial. Në fund tha se logjika e gjithë kësaj është që të ndërtohet një sistem për të gjithë, d.m.th. nuk është për një individ apo një anëtar, nga cila do strukturë që vjen, as nga Këshilli Prokurorial as nga ata të cilët zgjidhen si tre anëtarë shtesë. Si përfundim ai tha se materialet i keni, gjithashtu edhe mendimin që e ka dhanë Komisioni Evropian është përkrahur pothuaj nga të gjithë të pranishmit, dhe kërkoi që edhe komisioni ta përkrah një rekomandim të tillë.

Agim Aliu- Tha që është mirë që erdhi deri te ky përfundim që të tërhiqet ky amendament i këtij ligji. Më tej shtoi se me një mandat do të duhet të përmbyllet e gjithë puna, kemi edhe shembuj në institucione të pavarura që kanë mandat pesëvjeçar dhe nuk konkurrojnë më për mandat tjetër shtesë. Ai përkrah arsyen që është bërë në rekomandim dhe thotë se është i pranueshëm ky rekomandim.

Nezir Cocaj -Rekomandon që anëtarët të mos kenë ndikim politik dhe të mos kenë varësi kolegjiale, të kenë mandat trevjeçar me pamundësi vazhdimi.

Armend Zemaj – Sqaron se nuk është hyrë në detaje të jetëgjatësisë së mandateve, pasi një gjë e tillë ishte e caktuar me Kushtetutë, por për këtë çështje kërkoi që të diskutohet njëherë tjetër, por sa i përket gjyqësorit ai tha se është paraparë që një mandat të jetë pesëvjeçar, dhe se ne jemi bindur që një mandat i tillë është i mjaftueshëm. Në fund Zemaj u pajtua që kjo duhet të procedohet ashtu siç është.

Kryesuesja - Në fjalën e saj të serishme tha se gjatë punës në grup punues kishte edhe mendim nga ana e Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili shprehu edhe disa interesa të anëtarëve të këshillit të cilët pajtohen se pakoja e ligjeve që rregullon fushën e gjyqësorit dhe fushën e prokurorisë janë pako që duhet të kenë një rregullim procedural unik. Kryesuesja më tej shtoi se rekomandimet që kanë ardhur nga komisioni i Venedikut dhe rekomandimet nga organizmat ndërkombëtarë dhe vendor lidhur me këto çështje, si dhe diskutimet me sponsorizuesin kanë sjellë një përfundim, që ky ligj edhe pse në fazë të implementimit, ne mund të kërkojmë të mos aprovohet, pasi që 2 nenet thelbësore që ishin propozuar për plotësim-ndryshim nuk ishim dakord që të behën të tilla. Më pas kryesuesja (Zj. Halimi) lexon rekomandimin e komisionit, ku kërkohet të mos miratohet projektligji 05/L-070 për ndryshim-plotësimin e ligjit nr. 03/L-224 për këshillin Prokurorial të Kosovës. Ajo me tej paraqet edhe

arsyetimin para komisionit dhe gjithashtu tha se duhet ta paraqesë edhe para kuvendit. Arsyetimin e mbështeten anëtarët që ishin të pranishëm në komision.

Armend Zemaj- Rekomandon që të fillohet procedura e plotësimit- ndryshimit për të dy ligjet, për këshillin prokurorial dhe këshillin gjyqësor të Kosovës, sa i përket zyrës së prokurorit disiplinor për parashkrimin e lëndëve, të cilat janë në procedurë disiplinore. Zemaj tha se ne kemi rekomanduar që procesi të fillojë nga qeveria, sepse është më i shpejtë. Ai gjithashtu theksoi se është dëgjuar edhe përfaqësuesi i zyrës së prokurorit disiplinor, që e ka dilemën që shkurtimi i afateve mund të ketë pasoja në sjelljen e njerëzve gjatë ushtrimit të mandatit, qoftë të prokurorit, qoftë të gjyqtarit. Z. Zemaj kërkon që komisioni ta përkrahë dhe ky rekomandim t'i shkojë pastaj qeverisë.

Kryesuesja- Potencion se gjatë grupit punues kur është punuar për projektligjin për këshillin prokuroria jemi njoftuar nga përfaqësuesit e qeverisë se qeveria, gjegjësisht Ministria e Drejtësisë i ka dërguar shkresë të gjitha institucioneve që ato të shprehin çdo shqetësim lidhur me zbatimin e ligjeve aktuale dhe të paraqesin raport, ku duhet të plotësim-ndryshimi dhe i cilave ligje. Ajo me tej shtoi se gjithashtu nga drejtori i zyrës së prokurorit disiplinor është kërkuar që ne ta paraqesim këtë shqetësim në ministri dhe të mos vonohet në radhitjen e legjislacionit për plotësim - ndryshim.

Pas diskutimeve, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

- I. Të mos miratohet, Projektligji nr. 05/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.*
- II. I rekomandohet Ministrisë së Drejtësisë që të përfshihet në programin legjislativ për vitin 2016, ndryshimi dhe plotësimi i ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L -033 dhe ndryshimi dhe plotësimi i ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L -035*

5 Të ndryshme

Komisioni cakton mbledhjen e radhës e cila do të mbahet më 08.12.2015.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,
Selvije Halimi
